



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor
Mbledhja nr. 54
Prishtinë, më 28.12.2016, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S1

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Adem Salihaj, Emilija Rexhepi, Shaip Muja, Time Kadrijaj, Murat Hoxha, Haxhi Shala dhe Salih Salihu.

Mungoi: Sergjan Popoviq.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Duda Balje**, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky :

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 15.12.2016;
3. Shqyrtimi i kërkesës së banorëve të Hades;
4. Takimi me përfaqësuesin e Këshillit ndërministror për ujëra,
5. Të ndryshme.

Kryesuesja **Duda Balje**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të përcaktuar të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës për këtë mbledhje u miratua pa ndonjë shtesë.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 15.12.2016

Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 15.12.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i kërkesës së banorëve të Hades

Duda Balje, kryetare, rikujtoi Komisionin se në mbledhjen e fundit është kërkuar nga banorët e Hades përgjegje të sakt çka sugjerojnë lidhur me çështjen apo problemin e tyre, ndaj njoftoi se ata përmes përfaqësuesit të tyre kërkesën përfundimtare e kanë hartimin e një ligji të veçantë për dislokimin e tyre nga ky fshat. Ftoi komisionin të deklarohet rreth iniciativës së këtyre banorëve.

Adem Salihaj si përkrahës i kërkesës së këtyre banorëve për një ligj arsyetoi kërkesën e banorëve ngase deri tani institucionet shtetore vetëm kanë sjellë propozime dhe asgjë tjetër, ndaj i mendimit ishte se poçes siellet ky ligj, ka gjasa që në fund të vitit 2019 të përfundoj ky problematikë me këta banorë, vetëm një arsye është pse duhet ligj, ajo është ngase ligji obligon.

Shaip Muja ju drerjtua kryetares duke potencuar se ajo është joserioze dhe luan rolin e një OJQ-je ngase sa herë është potencuar nga ai se Neni 6 i Ligjit për Obiliqin dhe Neni 18 i Ligjit për miniera e minerale (përmes taniemës që do të mblidhet) rregullon edhe problemin e Hades, gjithashtu si tentim shtesë ceku se banorët duhet ti drejtohen kryetarit të komunës Obiliq që bashkarisht të zgjedhin problemin tani me Ligjin që sapo ka hyrë në fuqi. Ligji që sugjerohet me shumë gjasa nuk do të miratohet dhe nuk zgjedhet ashtu asnjë problem.

Kryetarja Duda Balje reagoi dhe potencoi se “asnjë interes nuk ka me këtë çështje, nuk luftoi për asnjë votë por është thjeshtë dhembja ime, thjesht kam pa këtë problem dhe dëshiroj të jap kontributin tim për zgjedhje, është iniciativa e qytetarëve prej vitit 2004 ajo duhet të plotësohet dhe duhet të tregohet humaniteti, asgjë tjetër”.

Emilija Redzeqi apeloi për tone jo me nervozë por të gjendet zgjidhja për këta banorë, në këtë rast, shtoi ajo, përkrahu deputetin Shaipin ngase nuk na nevojitet ligji dhe nuk na nevojitet kampanja publike por thjeshtë një rekomandim apo rezolutë duke ftuar të gjitha partitë për unitet.

Time Kadrijaj potencoi kundërthënjet evidente të cilat mund të bëhen pengesë serioze në fund, ndaj një zgjidhje duhet të kërkohet nga Qeveria e cila asgjë nuk po ndërmerr përkundër këtyre fakteve që janë për të ardhur keq dhe evidente. Pasi që nga praktika shihet se edhe Ligji i miratuar nuk zbatohet (shëndetësia), ajo sugjeroi të ftohet kryetari i Obiliqit dhe të pytet sa mund të kontribojë në këtë drejtim ose përfundimisht me rezolutë të veprohet ose monitorim.

Haxhi Shala potencoi se komisioni është bindur se në Hade nuk ka jetë normale, pa mar parasysh si vepron komisioni, Qeveria asgjë nuk ndërmerr, kurse sot këtu shohim dy mendime, njëra me nxjerrë ligjin tjetra mos me nxjerrë, asgjë nuk është e qartë, ndaj

sugjeroi që secili të flas me shefin dhe varësisht çka vendoset pastaj të bashkëngjitemi për ligj apo të kundërtën.

Adem Salihaj potencoi se antarët e komisionit duhet të siellen si të tillë por jo si të varur nga dikush, ngase këtë e kanë të garantuar me kushtetutë, ne duhet, vazhdoi, të propozojmë kurse Qeveria të zbatojë. Ligji i Obiliqit përmirëson mjedisin por jo edhe dislokimin, ai rikujtoi se shumë rekomandime janë nxjerrë nga Komisioni por ato nuk zbatohen jo vetëm nga kjo Qeveri, por është praktikë e secilit qeveri të pasluftës, me këtë propozim nuk propagandohet, por zgjedhet problemi dhe nuk është problemi ynë a do të kaloi apo nuk do të kaloi, insistoi ai në fund.

Pasi që edhe një herë u përsëritën retorikat e arsytimit dhe kundërshtimit të ligjit nga **Kryetarja** dhe **Shaip Muja**, kryetarja pyeti komisionit kush është për dhe kundër (apo abstenim), rezultati i votimit ishte **4 për ligjin kurse 2 për abstenim**, ndaj Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e banorëve të fsh. Hade rreth hartimit të Ligjit të veçantë për çështjen e zhvendosjes së banorëve të Hades.
2. Në mbledhjen e radhës Komisioni do të nxjer vendimin për nismën e hartimit të ligjit kur do të caktohet edhe grupi punues.

4. Takimi me përfaqësuesin e Këshillit ndërministror për ujëra

Pasi që kryesuesja ja dha fjalën **Baton Begolli** filloi raportimin për organizimin e sektorit të ujërave dhe gjendjen duke potencuar se këtë sektor më 1990 nga ish sistemi jugosllav nuk e kanë pranuar si të qëndrueshëm përkundrazi është dashur shumë përpjekje dhe fillimisht ky sektor është ndarë nga Komunitat për shkak të mbulimit të ulët të shërbimeve, klientelizmit, njohurive të mangëta në menaxhim, ndërhyrje politike, ndërsubvencionimi, kërkesa të mëdha me mundësi të kufizuara, koordinimi joefektiv, projekte të shtyra nga donatorët jo doemos nga nevoja, etj. Ndarja e menaxhimit të shërbimeve ujore nga komunitat ka rezultuar nga 30 në 7 kompani rajonale të ujit dhe krijimin e tarifave jo diskriminuese në tërë zonën e shërbimit. Tani menaxhimi bëhet, resurset ujore në kompetencën e MMPH kurse menaxhimi i shërbimeve ujore nga MZHE, si dhe rregullatorët : ARRU (ekonomik), MMPH (mjedisor) dhe IKSHP (shëndetësor – cilësia e ujit të pijes). Këshilli Ndërministror për Ujërat në kryeministri (KNMU) është organi vendimmarrës dhe koordinues për tërë sektorin dhe çështjet ndër-institucionale. Gjendja sot është 87% e popullatës kanë qasje në ujësjellësin publik, 65% në kanalizim, ka filluar trajtimi i ujërave të zeza, por uji i pa faturuar mbetet i lartë, në 56% dhe inkasimi i ulët në 78%. Sa i përket sfidave ai potencoi mbrojtjen e reformave (kryesisht ruajtjen e ndarjeve institucionale), zbatimin e ligjit të ujërave (lejet, obligimet financiare, siguria e digave, zonat e mbrojtura, eksploatimi i lumenjve, mbrojtja nga përmbytjet, etj), konsolidimi i mëtejme (në veri dhe Ferizaj), trajtimi i ujërave të zeza me grante e jo me kredi, adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike, proceset e aderimit në BE, freskimi i kuadrave me profesionistë të rinj.

Në fund kujtoi se në botë nga tërë uji vetëm 2.5% janë ujëra të ëmbla kurse 0.07 % të shfrytëzueshëm. Në Kosovë nuk ka hulumtime sa kemi ujëra nëntokësorë dhe jemi shtet me stres ujor, prandaj secila politikë zhvillimore nuk ka mundësi të zbatohet nëse nuk ka ujë, ndaj kjo seriozisht duhet të jetë objekt mendimi për zhvillimin e ardhshëm.

Haxhi Shala, Adem Salihaj falënderuan për informata dhe theksuan se komisioni duhet më hollësisht të kërkoj informata tepër të rëndësishme për faktet që u dëgjuan sot, sidomos pse shfrytëzohen kreditë e jo grante, pse Qeveria paguan 500.000 euro në vit në veri kompanive në emër të banorëve dhe bënë disa pyetje për shkaqet e moszhvillimit të këtij sektori. Z. Begolli propozoi kontrollim dhe mbikëqyrje shumë më serioze, konkretisht potencoi se ARRU licencon kompanitë rajonale të ujësjellësve por mundet edhe të zbatoj kushtet e licencimit. Rreth pyetjeve të **Kryetares** dhe **Emilija Redzepi** pse regjioni i Zhupës nuk lidhet me KRU Hidroregjioni Jugor përkundër faktit që kanë ndërtuar me vetkontribut, z. Begolli përsëriti arsyet e cekura më lartë rreth rolit të ARRU-së por edhe të monitorimit të ligjit i cili shumë më tepër duhet të praktikohet nga komisioni.

Mbledhja përfundoi në orën 12:05.

E përgatiti:

Kryetarja e Komisionit,

Duda Balje

Stafi Mbështetës i Komisionit.